



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:029879

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505817

P.nr.487/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Arbnijë Gashi, në lëndën penale, kundër të akuzuarit L.K., nga Prishtina, rruga '.....' pn, për shkak të veprës penale, Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par.1.1 lidhur me par. 2 nën par. 2.6, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)04/L-082, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren PP/I. nr.213/17-l,të datës 14.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit Musli Gashi, të akuzuarit L.K., dhe mrojtësit të tij av. H.M., me datë 14.03.2024 mori, ndërsa përpiloi me shkrim me datë 26.03.2024 këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

L.K., nga i ati dhe e ëma, mbiemri i vajzërisë së nënës, i lindur me datë, në Prishtinë, ku dhe jeton në rrugënpn, i martuar, i ati i një fëmije, automekanik, ka të kryer shkollimin e mesëm, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Personit tjetër ia merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, duke pasur me vetë armë apo mjet të rrezikshëm dhe duke depërtuar me forcë në hapësira të mbyllura, në atë mënyrë që me dt.03.09.2017, rreth orës 02:17 min, në rr ".....", në Prizren se bashku me tre persona tjerë të panjohur me automjetin e tipit ".....", me ngjyrë gri, pa targa i afrohet lokalit ".....", e pastaj me të njëjtit del nga vetura dhe me disa shkopinjtë të drurit me forcë e thyejnë derën e lokalit, depërtojnë në brendësi, marrin një laptop dhe me të u afruar tek vetura njëri nga personat e maskuar shkrep në drejtim të qiellit dhe me ata largohet nga vendi i ngjarjes, me ç' rast të dëmtuarit K.H., i shkakton dëm të konsiderueshëm material.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale, Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par.1.1 lidhur me par. 2 nën par. 2.6 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 17, 42, 43, 45, 46, dhe 73, të KPRK-së dhe nenin 242 e neneve 364 dhe 365 të KPRK-së të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 16.02.2021 deri me datë 14.05.2021.

Dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej treqind (300) euro, të cilin dënim do ta paguaj në llogarinë e kësaj gjykata nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e nëse dënimi me të holla nuk mund të paguhet nga ana e të akuzuarit në afatin ligjor, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur 20 euro për 1 dite burgim, gjegjësisht 15 ditë burgim.

I dëmtuari K.H., nga Prizreni, me vendbanim në lagjen Petrovë, rr."", pn, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në bazë të llogarisë se gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 100,00 euro, në zbatim të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit të akuzuarit i caktohet taksa në shumën prej 20,00 euro, të cilën është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP/I. nr.213/17-1,të datës 14.04.2021, ndaj të akuzuarit L.K., nga Prishtina, rruga " "" pn, për shkak të veprës penale, Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par.1.1 lidhur me par. 2 nën par. 2.6, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas pranimin të shkresave të lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues me datën 14.03.2024 ka caktuar shqyrtimin fillestar, ku i akuzuari pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit konform nenit 241 të KPPRK-së, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, vullnetarisht, në konsultim me mbrojtësin e tij av.H.M., e ka pranuar fajësinë që i ngarkohet me aktakuzë.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë për faktin se i akuzuari përfaqësohet nga mbrojtësi i tij për çka edhe nga gjykata paraprakisht është njoftuar lidhur me pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë, me qenë se ky pranim i fajësisë gjene mbështetje në KPP, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënon sipas ligjit, gjatë matjes së dënimit të merret parasysh pranimi i fajësisë në këtë shqyrtim gjyqësori dhe si rrethane rënduese i njëjti është recidivist i veprave penale.

Avokati mbrojtës ka theksuar se pas konsultimeve me klientin e tij të cilit ja ka sqaruar të gjitha pasojat dhe benifitet që rezultojnë me rastin e pranimin të fajit, ka kërkuar nga gjykata që të vlerësoj rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit, shprehja e pendimit për veprën e kryer, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe se pas ngjarjeve të cilat i kanë ndodhur në shtetin e Belgjikës, ku ka përfunduar me lëndime tejet të rënda trupore nga arma e zjarrit të njëjtit ti shqipton një dënim sa me të butë.

I akuzuari ka deklaruar se pa asnjë shtrëngim dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, e pranon fajësinë në këtë çështje penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 241 lidhur me 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuarit e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe konform nenit 241 e 242 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtim fillestar nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës si: përmbajtja së dosjes së forenzikës me nr.të dosjes 2017-RVK-346 të dt 03.09.2017, së bashku me raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes së bashku me fotoalbum, shpalljes nga faqja merr jep, ku shihet shitja e veturës ".....", së bashku me disa fotografi të veturës në shpalljen dhe veturës në vendin e ngjarjes, fotografive të marra nga rrjeti social "....." me nr.i dëshmitarit R dhe numrit të telefonit +....., në përdorim të të akuzuarit, të dt.29.08.20217, ku shihen bisedat për blerjen e veturës, listës së dëshmive me zinxhir të ruajtjes me nr. 2017-GA-1794, e dt.03.09.2017, raportit të ekspertimit me nr. ref. AKF/2017-2781/2017-2485, të dt. 13.09.2017, CD me video-incizime të marra nga pompa e benzinës ".....", në fsh.Kramovik, të dt,29.08.2017, CD- me hartografi të numrit +....., CD- me video-incizime, të marra nga vendi i ngjarjes nga ".....", të dt.03.09.2017, si dhe provat dhe shkresat e tjera në lëndë, janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme, që tregojnë se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e veprës penale .

Andaj kjo gjykatë duke u bazuar në këto që u thanë më lart vërtetohj gjendjen faktike se në veprimet e të akuzuarit L.E., plotësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale, Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par.1.1 lidhur me par. 2 nën par. 2.6, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, prandaj dhe ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitës së nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, sjelljen e të akuzuarit pas rastit, keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari si dhe premtimin se do të jetë më i kujdesshëm nuk do të përsëris më vepra penale, si dhe rrethanave personale se është i gjendjes së dobët ekonomike, mbajtës i familjes- i ati i një fëmije. Si rrethanë rënduese ndaj të dëmtuarit gjykata gjeti, pjesëmarrjen e lartë të akuzuarit në kryerjen e veprës penale, rrethanat në të cilat e ka kryer veprën penale – me mjetin e rrezikshëm armën, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer, me rrethanat personale dhe shkallen e përgjegjësisë të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, e mori në kuptim te nenit 449 dhe 451 të KPPK-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, e mori në kuptim te nenit 457 të KPPK-së.

Vendimi mbi pagesën e taksës në emër të Programit për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
P.nr.487/2021, i datës 26.03.2024

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.